



KONTRATE

PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE “DATECH” sh.p.k.

NDERMJE

HASAN BASHA, i biri i ALI BASHES, lindur ne SHKODER, me 27.01.1930, banues ne TIRANE, me numer pasaporte AZ 483292

ARBEN ISLAMI, i biri i XHEMIL ISLAMIT, lindur ne TIRANE, me 15.05.1955, banues ne TIRANE, me numer pasaporte AZ 046113

Themeluesit ne baze te ligjeve te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise Nr.7512, date 10.08.1991, ligjt Nr. 7632, date 04.11.1992, ligjt Nr. 7638, date 19.12.1992, dhe ligjt Nr.7764, date 02.11.1993, u moren vesh si me poshte:

NENI 1

Te themelojne nje shoqeri tregtare per te zhvilluar veprimitari private te emeruar “DATECH” sh.p.k. (shoqeri me pernjegjesi te kufizuar).

Shoqeria do te kete seline e saj ne Republiken e Shqiperise, ne Tirane, rruga “Sami Frasher” P. 9.

NENI 2

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar shoqeria eshte PERSON JURIDIK. Veprimitaria e saj do te rregullohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, te statutit te saj dhe te ligjeve shqiptare.

Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjesa perberese e saj. Shoqeria per gjigjet vetem me pasurite e saj dhe ne asjne rast nuk per gjigjet per detyrimet e ortakeve.



Ortaket nuk perjigjen personalisht per detyrimet e shoqerise dhe nuk perballojne humjet pertej kuotes se tyre.

Shoqeria nuk perjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

OBJEKTI

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetë:

Prodhime ne fushen informacionit dhe teknologjise se informacionit, projektim dhe realizim te programeve aplikativ per fusha te ndryshme te ekonomise per strukturat publike dhe ato private, hedhje, perpunim dhe ekzekutim te dhenash, ndertim rrjetash kompjuterik si dhe asistence teknike per produktet e realizuar nga ana e saje.

Objekti i shoqerise perfshin gjithashtu te gjitha operacionet mobiliare dhe imobiliare, financiare, komerciale apo transporti qe lidhen direkt apo indirekt me objektin e mesiperme ose me gjithe objektet te lidhur ose qe mund te ndihmojne ne realizimin e objektit te shoqerise.

Parashtesat e mesiperme qe lidhen me objektin e veprimtarise dhe kompetencat e saj do te vleresohen te pacenueshem.

Keto veprimitari synojne ne arritjen e objektivave te larte permendura, duke respektuar dhe ne perputhje me programet e veprimtarise ekonomiko financiare te parashikuara dhe te miratuara nga Asambleja e Ortakeve.

Shoqeria ka te drejte te zgjeroje objektin e veprimtarise se saj edhe ne drejtime te tjera, ne perputhje ne vendimet e asamblese se ortakeve.

NENI 4

Kohezgjatja e shoqerise eshte 99 vjet, e caktuar deri ne 31 Dhjetor 2097, me mundesine e zgjatjes ose te shkurtimit te ketij afati para kohe, me vendim te asamblese se per gjitheshme te ortakeve.



Kjo marreveshje dhe lidhjet e saj perfaqsojne marreveshjen e pote midis ortakeve. Kjo mund te ndryshohet, te integrohet ose te plotesohet vetem me marreveshje me shkrim midis ortakeve.

KAPITALI THEMELOR

NENI 5

Kapitali themelor i shoqerise eshte baraz me 100.000 leke (Nje qint mijë). Ortaket marrin pjese ne kapitalin themelor si me poshte:

HASAN BASHA	60 000 leke	baraz me 60 %
ARBEN ISLAMI	40 000 leke	baraz me 40 %

Kapitali themelor do te perbehet nga mjetet e nevojshme monetare te paleve, te perfaqsuar nga Zoterinje HASAN BASHA dhe ARBEN ISLAMI qe do ta derdhin fillimisht dhe here pas here ne nje banke Shqiptare, ku do te hapet nje llogari rrjedhese.

Kontributet e ortakeve do te shenohen ne librin e llogarise, ne regjistrin e posaçem te Shoqerise.

Çdo ortak ka te drejten te mbaje nje dokument per verifikimin e derdhjes se kuotes se tij.

NENI 6

Ortaket kane te drejte t'i ndryshojne perqindjet ne kapitalin themelor ne mes tyre, ne perputhje me ligjin, ne favor te bashkeshorteve, trashegimtareve paraardhes dhe pasardhes.

NENI 7

Asambleja e ortakeve emeron organet drejtuese. Menyra e krijimit, funksionet dhe veprimtarite e te gjitha organeve do te caktohen ne statutin e Shoqerise.

NENI 8



Shoqeria e fillon veprimtarine e saj diten e regjistrimit ne Gjykaten e Shkalles se Pare ne Tirane, dhe ne zyren tatimeve te caktuar nga Ministria e Financave (Zyra e taksave te Qytetit te Tiranes).

NENI 9

Fitimi neto i shoqerise, pasi te jene hequr shumat qe u perkasin detyrimeve ligjore dhe fondit rezevre, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, u ndahen ortakevet perpjestimisht me kuotat e pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themelor te Shoqerise, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Fitimi dhe shperblimet e tjera mund te trasferohen lirisht jashte shtetit ne valute te konvertueshme, ne llogarite rrjedhese te caktuara nga Shoqeria.

NENI 10

E gjithe veprimtaria e Shoqerise dhe investimet e saj mbrohen nga Shteti, i cili i garanton Shoqerise te njejtin trajtim dhe te njejtat te drejta qe parashikohen dhe per personat e tjere juridike shqiptare.

DETYSIMET E ORTAKEVE

NENI 11

Ortaket detyrohen reciprokisht te ruajne sekretin dhe dokumentat e shoqerise, te dhenat dhe pervojen e grumbulluar gjate veprimtarise se saj.

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

NENI 12

Ne rast mosmarrveshje, per zgjidhjen e tyre palet zgjedhin nga nje perfaqsues dhe nje te trete, ne rolin e kryetarit, me miratimin e te dy paleve. Kur mosmarrveshjet nuk arrihen te zgjidhen me mirkuptim, palet kane te drejte ti drejtohen Gjykates ose Arbitrazhit ne Republiken e Shqiperise.



NENI 13

Per te gjitha çeshtjet qe nuk shenojen ne kete kontrate dhe ne statutin e Shoqerise do te zbatohen dispozitat e kodit civil dhe normat e tjera ne fuqi te Republikes se Shqiperise.


NENI 14

Kjo kontrate u hartua ne 4 (Kater) kopje, ne gjuhen shqipe dhe perbehet nga pese faqe e katermbedhjete nene.

Palet pasi e lexuan dhe nuk paten verejtje, e firmosen.

ORTAKET

HASAN BASHA



ARBEN ISLAMI

